



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0521

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Kryetare, Vjosa Gradinaj Mexhauni Anetare dhe Vedat Poterqoi Anetar, duke vendosur sipas ankesës së OE N.N.P. "Euro Construction", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit" me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Gjilan, më 09/08/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE N.N.P. "Euro Construction" e datës 18.06.2024 me numër protokolli 2024/0521 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit", me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1.
2. Anullohet, aktiviteti i prokurimit "Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit", me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Gjilan, i njejt mund të Ritenderohet.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
4. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 07.12.2023, Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit", me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1.

Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara është publikuar me datën 04.03.2024.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën për punë. Vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.000.00€.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-se për dhënie të kontratës është publikuar 31.05.2024 OE N.N.P. "Euro Construction", me datën 05.06.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Më datë 10.06.2024, AK, Komuna e Gjilanit me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues. Të pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues N.N.P. "Euro Construction", me datën 18.06.2024, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2024/0521, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP.

Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave-

(a) Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

(b) Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

(c) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar.

Lidhur me këtë, me 17.07.2024 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim: Ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, Të anulohet njoftimi i AK për dhënie të kontratës

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues shkurtimisht janë prezantuar si në vijim N.N.P.

"Euro Construction" në ankesën Nr. 521/24 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): *Ankuesi pretendon*: "Sipas operatorit ekonomik ankues është eliminuar sepse nuk ka vendosur çmimin në paramas tek pozicioni E 15.8".

Pretendimi i dytë (II): *Ankuesi pretendon*: "...është eliminuar padrejtësisht nga aktiviteti i prokurimit pasi që sipas vlerësimit nga autoriteti kontraktues Udhëheqja e Punishtes e prezantuar në ofertë nuk e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktues".

Pretendimi i tretë (III): *Ankuesi pretendon*: "Operatori ekonomik ankues pretendon se është eliminuar padrejtësisht në lidhje me pikën gj) OE duhet të prezantoj punëtorë të profileve të ndryshme, të çertifikuar nga një Institucion i Republikës së Kosovës apo nga ndonjë kompani e licencuar, ku duhet të këtë së paku nga".

Pretendimi i katërt (IV): *Ankuesi pretendon*: "GOE ankues nuk i është lejuar çasja në dokumentet zyrtare në harmoni me nenin 10 të LPP-së". Pretendimi i pestë (V): *Ankuesi pretendon*: "GOE ankues dyshon se konzorciumi i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklarata nga banka për çasje në kredi të pa kushtëzuara dhe se nuk ka mjete në llogari sipas vlerave të kërkuara". Pretendimi i gjashtë (VI): *Ankuesi pretendon*: "Përmes këtij pretendimi ankimor GOE ankues pretendon se inxhinieret e ofruar nga GOE të rekomanduar për kontratë nuk janë konform kërkesave dhe nuk janë të punësuar sipas ligjeve në Kosovë. Pretendimi i shtatë (VII): *Ankuesi pretendon*: "GOE ankues pretendon se pajisjet e ofruara mungojnë apo nuk janë ofruar sipas kërkesave të aneksit 7 të dosjes së tenderit". Pretendimi i tetë (VIII): *Ankuesi pretendon*: "GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën sipas dosjes së tenderit në lidhje me dorëzimin e Vlerësimit të riskut nga një kompani e licensuar".

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në kërkesën për rishqyrtim të OE N.N.P. Euro

Construction shkurtimisht janë prezantuar si në vijim:

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues (AK) ndaj ankesave të OE "Euro Construction" janë të përqendruara në refuzimin e pretendimeve për eliminim të padrejtë nga prokurimi, bazuar në ligjin e prokurimit publik. AK ka argumentuar se mospërcaktimi i çmimit në një pjesë të ofertës, çertifikatat e paraqitura që tregojnë vetëm pjesëmarrje në kurse dhe jo kalimin e provimeve të nevojshme, si dhe dokumentet që tregojnë vetëm pjesëmarrje në trajnime pa një vlerësim formal të kualifikimeve profesionale, janë të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu, AK ka sqaruar se ka ofruar akses të kufizuar në dokumentacion për të mbrojtur sekretet afariste dhe të dhënat personale, duke respektuar kufizimet ligjore. Në fund, AK i ka refuzuar të gjitha ankesat si të pabaza, duke theksuar se të gjitha veprimet dhe vlerësimet e saj janë në përputhje me ligjin dhe nuk kanë diskriminuar ose favorizuar ndonjë palë.

Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/052, lidhur me pretendimet e OE N.N.P. "Euro Construction", ka vlerësuar pretendimet si në vijim: Konstatimi i parë (I): Eksperti shqyrtues konstaton se sipas nenit Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik nr 001/2023 neni 10.1 në rastet kur lista e çmimeve nuk është plotësuar atëherë tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm: Paramasa dhe parallogaria ka edhe disa pozicione tjera paushallë që janë kërkuar mirëpo në pozicione tjera operatori ekonomik

ankues ka plotësuar çmimet ndërsa tek poz. Nr E 15.8 nuk ka plotësuar çmimin. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm, dosjen e tenderit, paramasen dhe parallogarin, ne përgjithësi shkresat e lëndës konstatojmë se pretendimi ankimor nr. 1 është i pa bazuar. Konstatimi i dytë (II):Eksperti shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues ka kërkuar ne dosje te tenderit ne lidhje me ketë pikë si ne vijim: - Kërkesab). Një udhëheqës i punishtes-Inxhinier i diplomuar ose mastër i Arkitekturës, i certifikuar me FIDIC dhe i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standardit DIN EN 16247, me minimum 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme- ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët. Operatori ekonomik ka ofruar një certifikat nga FIDIC për Udhëheqësin e punishtes me përmbajtjen si me poshtë:Bazuar në përshkrimin e kriterit te përzgjedhjes se certifikatës FIDIC, sqarojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar saktë dhe me sqarime te nevojshme ketë kërkesës sepse vetëm ju ka referuar si kërkesë “certifikim me FIDIC” pa specifikuar llojin e certifikimit. Operatori Ekonomik ankues ka ofertuar certifikaten ne emër te Anita Sadikaj për pjesëmarrje ne modulet FIDIC Module 1: Practical of Fidic Conditions of Contracts, training hours 14.00 mbajtur me datat 19 deri 20 Maj 2023. Sipas sqarimeve dhe përshkrimit te mësipërm konstatojmë se një kërkesë e tillë ka qenë e përgjithësuar ne dosje te tenderit dhe kjo ka shkaktuar edhe paqartësi tek operatorët ekonomik ofertues duke ofruar certifikata te ndryshme. AK-Komuna e Gjilanit është dashur ne dosje te tenderit te sqaroj saktë llojin e certifikates se kërkuar ashtu siç e ka sqaruar ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar. Eksperti shqyrtues ne lidhje me ketë pretendim ankimor konstaton sipas përshkrimit te mësipërm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor te bazuar. Konstatimi i tretë (III): Eksperti shqyrtues bazuar ne kërkesën e lartcekur te autoritetit kontraktues dhe ne ofertën e GOE ankues sqaron se operatori ankues ka ofruar punëtorët e certifikuar si ne vijim: 1. BD-Instaluese e gypave dhe tubave; 2. AG-Armirues; 3. BM- Armirues; 4. XhM-Latues; 5. ND – Latues; 6. NS-Murator; 7. MQ-Murator; 8. XHT-Suvatues; 9. AA-Suvatues; 10. VB-Moler; 11. HZ-Moler; 12. JH-Pllaka shtrues; 13. AZ-Suvatues; 14. HC-Teknik i Ndërtimtarisë; 15. BA-Inxhinier Elektrik; 16. BSH-certifikate për module te elektrikes; 17. AA-Murator; 18. IZ-Latues; 19. ATH-Suvatues-moler; 20. SHZ-Suvatues; 21. RH-Pllaka Shtrues; 22. DA-Elektro Instalues; 23. SM-Elektroinstalues; 24. GL-Hidroizues dhe hidorinstalues i ujit; 25. RA- Hidroizues dhe hidorinstalues i ujit. AK-Komuna Gjilan përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar thekson se për disa punëtor te cekur me iniciale janë certifikata për trajnime te mbajtura online dhe ju mungon pjesa praktike. Ne ketë rast ne lidhje me ketë pretendim ankimor sqarojmë se AK-Komuna Gjilan në dosje te tenderit nuk ka specifikuar se trajnimi a duhet te mbahet online apo me pjesëmarrje fizike te punëtorëve dhe një gjë e tillë nuk mundet as te kufizohet por me rendësi është marrja e certifikates dhe ofrimi i saj sipas kriterëve te përzgjedhjes ne dosje te tenderit. Rekomandojmë AK-Komuna Gjilan qe kriteret e përzgjedhjes ne dosje te tenderit te jenë te çarta dhe te kuptueshme për te gjithë operatorët ekonomik dhe te vlerësohet vetëm sipas kriterëve te përcaktuara paraprakisht ne dosje te tenderit dhe njoftimin për kontratë. Tek ky pretendim ankimor sqarojmë se AK-KK Gjilan ka vlerësuar ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se sepse ka dhënë arsytime për mospranim te trajnimit online qe nuk ka qenë kriter ne dosje te tenderit dhe njoftimin për kontratë. Duke marrë për bazë kërkesën e autoriteti kontraktues ne lidhje me ketë pike dhe certifikatat e ofruara nga GEO ankues konstatojmë se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar. Konstatimi i katërt (IV):Eksperti shqyrtues sqaron faktin se GEO i rekomanduar për kontratë ka plotësuar Kërkesën për Sekret afarist ku theksohet dhe i ka klasifikuar si dokumentet sekrete afariste dokumentet sipas nenit 68 dhe 69 te LPP-së. Nisur nga fakti se AK-Komuna Gjilan me datë 04.06.2024 i ka ofruar çasjen OE ankues konsiderojmë se ky pretendim ankimor është i pa

bazuar. Konstatimi i pestë (V): Eksperti shqyrtues sqaron ne lidhje me ketë pikë AK-Komuna Gjilan ka kërkuar ne dosje te tenderit si ne vijim: Kërkesa 2. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhironlogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku: 3,000,000,00 ose qasje në kredi te pa kushtëzuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për te cilin lejohet kredia. Dëshmia 2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhironlogari ose qasje në kredi te pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni. Eksperti shqyrtues sqaron se GOE te rekomanduar për kontratë ka ofruar deklaratat dhe konfirmimet nga banka ne lidhje me ketë pretendim ankimor si ne vijim: OE AVAG Group shpk nga TEB Banka, OE NPSH Bageri nga NLB Banka, OE Kosova Asfalt nga NLB Banka, OE EL BAU shpk nga TEB Banka dhe OE EL BAU shpk nga RBKO. Nga llogaritja e mjeteve te gatshme ne llogarit bankare dhe mjetet e lejuara ne formë te linjës kreditore konfirmojmë se GEO e tejkalon shumen e kërkuar nga autoriteti kontraktues ne lidhje me ketë kriter. Me qellim te mos publikimit te vlerave financiare për secilin operator individual nuk kemi paraqitur shumet e mjeteve financuara për operatoret ndaras. Konstatimi i gjashtë (VI): Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është mjaft i përgjithësuar sepse OE ankues nuk ka specifikuar cili inxhinier nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm konstatojmë se ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Konstatimi i shtatë (VII): Eksperti shqyrtues sqaron se edhe ky pretendim ankimor është mjaft i përgjithësuar sepse OE ankues nuk ka specifikuar se cilat pajisje mungojnë apo cila pajisje nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm konstatojmë se ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Sipas këtij pretendimi ankimor pretendohet se GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën për LEAD Auditor sipas standardit ISO 9001. Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje te tenderit për ketë kriter ka qenë si ne vijim: Kërkesa 3. OE të ketë një Lead Auditor sipas kërkesës së standardit ISO 9001, dhe i njëjti duhet të jetë i Certifikuar edhe për Siguri dhe Shëndet në punë, si dhe të jetë i trajnuar për Ekspert i mjedisit. Dëshmia 3. Kontrata ose para kontrata e punës, Diplomat ose certifikatat. Cv. GOE te rekomanduar për kontratë ne lidhje me ketë pikë kanë ofertuar inxhinierin Ramadan Basha, i cili posedon certifikatën LEAD Auditor, për Siguri dhe Shëndet ne punë dhe i licensuar nga MMPH për hartimin e raporteve për VNM. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm konstatojmë se ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Konstatimi i tetë (VIII): Sipas këtij pretendimi ankimor pretendohet se GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën sipas dosjes se tenderit ne lidhje me dorëzimin e Vlerësimit te riskut nga një kompani e licensuar. Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje te tenderit për ketë kriter ka qenë si ne vijim: Kërkesa 4. Vlersimi i rriskut për kompani nga një kompani e licensuar. Dëshmia 4. Vlersimi i rriskut për kompani nga një kompani e licensuar nga organi kompetent konform ligjit 04 L-161 (MPMS). Sqarojmë se GOE te rekomanduar për kontratë ne lidhje me ketë pikë ka dorëzuar raportin përfundimtar te vlerësimit te riskut te përgatitur nga kompania HSK LLC me NRB 71338002. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm konstatojmë se ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Konstatimi i nëntë (IX): Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesa në dosje te tenderit për ketë kriter ka qenë si ne vijim: Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet te ketë bazë për beton nga një kompani e licensuar ose marrëveshje për furnizim. Dëshmia: 5. Licenca apo leja e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale kopje ose marrëveshje për furnizim me OE e licensuar te jete origjinal ose e noterizuar nga origjinali dhe për ketë projekt). Eksperti shqyrtues sqaron se GOE ne ofertën e vetë ka përfshirë marrëveshjen ne emër te EL BAU shpk Gjilan dhe EKEN Beton, Prishtinë te dt. 12.01.2024 dhe lejen për aktivitete te veçanta (bazë e betonit) me

numër 688/KPMM/2019. Licenca përmban datën e lëshimit 26.04.2019 dhe të skadimit 25.04.2024 (në kohën e shqyrtimit të kësaj ankese është jo valide). Po ashtu sqarojmë se marrëveshja e nënshkruar në mes të EL BAU shpk Gjilan dhe EKEN Beton, të dt. 12.01.2024, nuk është në harmoni me Deklaratën për Themelimin e Grupit të Operatoreve Ekonomikë të dt. 04.03.2024 sepse në këtë marrëveshje i autorizuar për të nënshkruar në emër të grupit është partneri udhëheqës “Demiri Gartenbau gmbh” e jo EL BAU shpk si nënshkruese e kësaj marrëveshjeje në këtë rast. Bazuar në përshkrimin e mësipërm konstatohet se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Konstatimi dhjetë (X): Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje të tenderit për këtë kriter ka qenë si në vijim: 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblym të kontratës dhe dorëzohet të Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Eksperti shqyrtues në bazë të dokumenteve të përfshira në E prokurim tek dokumentet e pranueshmerisë sqaron se GEO të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar Vërtetimet nga ATK brenda afateve kohore të kërkesave të dosjes së tenderit pra brenda afatit 3 muor nga dorëzimi i tenderit. Bazuar në përshkrimin e mësipërm konstatohet se ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Sqarojmë se oferta ankuese ka një çmim më të lirë në total në raport me ofertën e rekomanduar për kontratë prej 1,723.088€. Eksperti shqyrtues sqaron se nga përmbajtja e ankesës rezultojnë 10 pretendime ankimore (jo të renditura sipas ankesës së operatorit ekonomik ankues). Në bazë të përshkrimit të mësipërm të gjitha pretendimeve ankimore, shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, raportit të vlerësimit nga komisioni i vlerësimit, ankesës së operatorit ekonomik ankues, sipas nenit 6 të LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, neni 59 i LPP-së, Neni 40 i Rregullores për Prokurim Publik eksperti shqyrtues rekomandon anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe ri tenderimin e tij nëse AK-Komuna Gjilan ka interes të ritenderoj. Rekomandojmë se gjatë fazës së ritenderimit kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit të jenë me të çarta dhe Autoriteti kontraktues të vlerësoj vetëm mbi bazën e këtyre kriterëve. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku janë deklaruar se nuk pajtohen me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

-Konstatimet e panelit shqyrtues-

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohej nga eksperti që të shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. .

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitjet dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale. Paneli krijoi bindjen e tij të pavarur se ankesa e OE ankues duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërsaq aktiviteti i prokurimit marre parasysh natyrën dhe vlerën parashikuar 15,000.00

euro, dhe shkeljet e evindetura nga eksepri shqyrtues të anulohet, duke e ritenderuar dhe hapur konkurrencën me kritere të qarta sikurse e kërkojnë dispozitat ligjore për faktin sikurse në vijim:

Paneli shqyrtues më tej pa pasur nevojë për detaje tjera shtesë, konstaton se anulimi i aktivitetit të prokurimit është i bazuar për faktin se kriteret e dosjes së tenderit nuk kanë qenë të hartuara si duhet nga autoriteti kontraktues. Në fakt, AK në kriteret e dosjes së tenderit ka vendosur kritere të cilat janë nuk janë në harmoni të plote me **nenin 51 të LPP-së** ku thotë: *“Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse”*, si dhe **nenit 17.12 të Rregullores Nr. 001/2022 për PP**, po citojmë *“Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sgaruese shtesë”*, andaj Paneli Shqyrtues pajtohet me ekspertin shqyrtues tek konstatimi nr. 2 dhe 3 në reaportin e ekspertit shqyrtues pasi që AK tek percaktimi i kritereve të përzgjedhjes nuk ka percaktuar qarte kërkesat duke lënë dykuptimesi dhe paqartesi të theksuara, kjo deshmohet edhe në përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim nga AK të datës 10.06.2024, duke dhënë arsye të cilat nuk janë specifikuar qarte në kërkesat teknike dhe profesionale në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë, konkretisht kërkesa 2 lidhur me stafin e profesional ku thotë: *“certifikim me FIDIC”* pa specifikuar llojin e certifikimit, standardin apo/modulin si dhe tek deshmia 2 e FDT-se, nuk është precizuar/saktesuar deshmia e certifikates, duke lënë paqartesi të theksuar, kurse tek stafi teknik, po citojmë: *“certifikuar nga një Institucion i Republikës së Kosovës apo nga ndonjë kompani e licencuar”* mirëpo AK me rastin e vendosjes këte kërkesë në DT nuk është specifikuar modulin dhe formën e trajnimit me pjesëmarrje fizike apo online, po ashtu duke lënë dykuptimesi dhe paqartesi të theksuar, gjë që pa mundëson një vlerësim të drejtë dhe meritore.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, gjetjet edhe konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit, AK nuk e ka respektuar **nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së**, ku thuhet: *“Autoriteti kontraktues nuk guxon të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatoreve ekonomik ose që diskriminon në dem ose në të mirë të një ose me shumë operatoreve ekonomi”*, si dhe **nenin 59 par. 4 të LPP-së**, ku thuhet: *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*, nga kjo rezulton se nuk janë marrë në konsideratë nga AK, pasi që neni 1 i LPP-së, parashihet qartë që qëllimi i LPP-së është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, kurse neni 6 i LPP-së parashihet që të gjitha autoritetet kontraktues, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë dhe lenden e prokurimit.

Prandaj, obligohet autoriteti kontraktues në të ardhmen të përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit, specifikimeve teknike – aneksit 1 të FDT-së dhe njoftimit për kontratë, duke respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, duke pasqyruar, kriteri kryesor për dhënie të kontratës të percaktuar në dosje të tenderit. Paneli Shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të **nenit 59 të LPP-së**, si dhe në pajtim me **nenin 62 par. 1.1. të LPP-së**, po citojmë: *“ një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në*

procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit” me tej Paneli shqyrtues vlerëson se dosja e tenderit nuk është hartuar konform nenit 51 të LPP-së dhe këte aktivitet të prokurimit autoriteti kontraktues obligohet të anulohet në tërësi dhe nëse akoma AK ka interes të iniciojë këte aktivitet të prokurimit mund ta ritenderoj.

Po ashtu paneli gjatë vendosjes për anulim të tërësishëm të këtij aktiviteti pati parasysh edhe

pretendimet tjera të ngritura nga ankuesi për të cilat nuk ia fali besimin ekspertit shqyrtues, ~~nuk i është lejuar çasja në dokumentet zyrtare në harmoni me nenin 10 dhe 11 të LPP-së, kurse ankuesi ka pohuar se të njëjtit~~ dyshon se konzorciumi i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklarata nga banka për çasje në kredi të pa kushtëzuara dhe se nuk ka mjete në llogari sipas vlerave të kërkuara në DT, lidhur me këto pretendime, paneli në konsistencë me qindra vendime të po këtij institucioni, ka kostatuar se një çasje e tillë e AK përbenë shkelje të parimeve bazë të LPP respektivisht nenin 7 trajtimi i barabartë i të gjithë ofertuesve, dhe po ashtu përben edhe shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP-së për faktin parimor se AK është e obliguar që para pranimit të kërkesës të jetë e bindur se publikimi i informatave të OE pjesëmarrësve mund ta dëmtojë biznesin etij, andaj në rrethana të tilla AK nuk ka ofruar ndonjë argument bindës në kërkesën për rishqyrtim se përse ofrimi eventual i dokumente të OE të rekomanduar mund ta dëmtojë të njëjtin, njëherësh paneli thekson se AK nuk mund të prejashtohet nga detyrimet ligjore dhe në çdo rrethanë duhet të ofrojë versionin e pastruar të dokumenteve, referuar dispozitave si në vijim: Neni 10 i LPP-së paragrafi 3. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron çasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë çasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur. Nderlidhur edhe me nenin 11 të LPP-së Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka çasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versionin e pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste. 5. Nëse dokumenti përmban vetëm informacione që autoriteti kontraktues i ka klasifikuar si informacione sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, dhe prandaj ky autoritet kontraktues vendos që këtë dokument ta largojë nga materiali në të cilin palët e interesuara dhe anëtarët e publikut kanë të drejtë çasjeje sipas paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kontraktues duhet të përgatis dhe përfshijë në dokumentacionin në të cilin publiku ka çasje, një përmbledhje të përmbajtjes së përgjithshme të dokumentit sekret. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të përmbledhjes së tillë një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar të gjitha informacionet që gjendeshin në dokumentin origjinal si informata sekrete

afariste, me kërkesë të operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) se dokumenti i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe se është një përmbledhje e përgjithshme jo-sekrete e origjinalit. Prandaj paneli shqyrtues nga kuadri i kompetencave të saja të parapara 105 të LPP, kërkon nga përgjegjësit brenda AK, të zbatojë në përpikëri të gjitha dispozitat ligjore pa prejashtim, sepse nëse vërtetohet edhe një herë në të ardhmën pra konstatohet që AK, nuk ka respektuar dispozitat e cituara si mësipër, do të kërkojë marrjen e masave eventuale ndaj zyrtarit që ka qenë përgjegjës dhe nuk ka vepruar sipas autorizimeve të dhëna nga ligjvënësi, në përputhje me nenin 25, paragrafët 8 dhe 9 të LPP-së.

Andaj paneli shqyrtues duke i pasur parasysh rekomandimet dhe sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues deklaron se ekzaminimi vlerësimi i tenderit nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së andaj edhe AK duhet të anulohet aktiviteti i prokurimit dhe të njëjtin nëse ka interes ta ritenderoj.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 6 i Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komeriale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK-KUVENDIKOMUNAL-GJILAN
- OE-N.N.P."EUROCONSTRUCTION"
- Arkivësë OSHP-së: